



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 16.03. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Hestet Cakolli, Mark Krasniqi
Enis Kervan, Donika Kadaj –Bujupi, dhe Dragan Dimiq
Mungon:, Memli Krasniqi.

Të ftuar: Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit Integritim Evropian dhe Ismet Beqiri- kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE - së, i NDI - së, përfaqësuesi nga Presidenca, përfaqësuesja nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e udhëhoqi: Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.02.2010
3. Shqyrtimi i strategjisë së Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritim Evropian
4. Të ndryshme

Kryesuesja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

1. Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.02.2010.

Kryesuesja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 23.02.2010 u miratua pa vërejtje.

Kryesuesja - i njoftoi anëtarët e Komisionit se për këtë takim është ftuar **Zylfije Hundozi** - kryetare e Komisionit Integritet Evropiane dhe **Ismet Beqiri**- kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni nuk ka informatë për mos pjesëmarrjen e Ismet Beqirit.

3. Shqyrtimi i strategjisë së Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropiane

Kryesuesja vlerësoi se Strategjia e Planit të Veprimit për Integritet Evropiane është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Nga ky plan i veprimit rrjedhin disa aktivitete të cilat e ngarkojnë komisionin tonë që në bashkëpunim edhe me komisionet tjera ti përmbushim detyrat në fushën e arsimit.

Komisioni për Integritet Evropiane ka paraparë që Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur do të ndihmojë në përmirësimin e gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Pas shqyrtimi të Planit të Veprimit komisioni do të hartoi Rekomandimin në fushën e arsimit të cilin do ta procedojë te komisioni për Integritet Evropiane. Lidhur me këtë pikë fjalën ia dha Zylfije Hundozit.

Zylfije Hundozi -, tha se në bazë të Planit të Veprimit i Kuvendit për Integritet Evropiane në pikat 45- dhe 46, vërehet një ngecje në arsimimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe në çështjen e trafikimit të fëmijëve dhe punës së fëmijëve.

Komisioni për Integritet Evropiane pas shqyrtimit të Planit të Veprimit ka konstatuar se në këto fusha janë të obliguar të kontribuojë Komisioni për Arsim dhe Komisioni për të Drejta të Njeriut. Ajo theksoi se këto dy Komisione duhet të kërkojnë nga MASHT-i Raport me shkrim për zbatimin e kornizës ligjore dhe përmbushjen e Planit të Veprimit për persona me aftësi të kufizuara. Më pas propozoi që të ftojme një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Integritet Evropiane, Komisionin për Arsim dhe Komisionin për të Drejta të Njeriut dhe të ftojme Ministrin e Arsimit i cili duhet të sjell Raport me shkrim.

Heset Cakolli -, përkrah iniciativën e znj, Zylfije Hundozi e cila është angazhuar të ketë sa më pak vërejtje në raportet e ardhshme në progresin për Integritet Evropiane. Në komisionin tonë janë të parapara që në tre mujorin e dytë, të shqyrtohet pika 44, 45, 46 të cilat kanë të bëjnë me çështjen e arsimit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu u pajtua të mbajmë një takim të përbashkët me tri komisionet e cekura më lartë dhe të ftojme Ministrin e Arsimit i cili do të ofrojë raport me shkrim lidhur me përmbushjen e kriterëve të këtyre çështjeve.

Donika Kadaj- Bujupi -, pajtohet me parafolësit që Komisioni të mbajë një takim të përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur ku do të ftohet Ministri i Arsimit i cili do të paraqes raport me shkrim, ku më pas komisioni do të nxjerr Rekomandim përfundimtar.

Enis Kervan -, theksoi se ka vërejtje teknike në pikën 5,2, dhe 5.3, lidhur me strategjinë e Trashëgimisë Kulturore dhe religjioze dhe se kjo çështje duhet të rregullohet dhe të përfshihet në Raport të Planit të Veprimit.

Në vazhdim ceku se ka mungesë të teksteve shkollore në gjuhën turke. Për arsye të tirazhit të vogël të librave, shtëpitë botuese nuk angazhohen për botimin e tyre sepse çështja financiare është pengesë për botimin e librave në gjuhën turke. Çështja e hartimit të programeve dhe librave shkollor në gjuhët e komuniteteve është problem politik dhe për këtë arsye kjo çështje duhet të ngritet para Ministrit të Arsimit, që të gjendet një zgjidhje e përhershme.

Në njërën nga mbledhjet e kaluara ka propozuar që Komisioni të vizitonte Fakultetin e Edukimit në Prizrenit me qëllim të njohjes së përafërt me institucionet arsimore në këtë komunë. Ai ka vërejtje, pse nuk janë përmbushur vendimet e marra nga ana e Komisionit.

Mark Krasniqi -, ceku se në bazë të raportit të Planit të Veprimit vetëm 10% të fëmijëve me nevoja të veçanta vijnë shkollimin dhe lidhur me këtë a ka kornizë ligjore për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesja -, konstatoi se në javën e ardhshme, komisioni do të mbajë mbledhje me datën 24.03.2010, në ora 11:00, ndërsa kërkoi që përfaqësuesi i ministrisë të raportojë për këto të dhëna:

- të dhënat e MASHT-it për numrin e personave me aftësi të kufizuar
- të dhënat e MASHT-it mbi shkallën e trafikimit të fëmijëve dhe punës së tyre
- masat për qasje në objektet shkollore të fëmijëve me aftësi të kufizuar
- shkalla e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në arsimin fillor,
- shkalla e analfabetizimit tek fëmijët me aftësi të kufizuar
- forma e përcaktimit të shkallës së dëmtimit të shëndetit mendor për pjesëmarrje në mësim dhe legjislacion.

3. Të ndryshme

Komisioni konstatoi që me datën 23.03.2010, të vizitonte Këshillin e Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe Institutin e Historisë.

Enis Kervan – tha se, është anëtarë i Forumit të Trashëgimisë Kulturore, ndërsa për shkaqe objektive propozoi që në vend të tij të caktohet një anëtarë tjetër nga komisioni.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11: 45

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit,

Drita Kadriu